

## STATUTI

### I SHOQËRISË “CIBE ALBANIA” SH.P.K

Në mbështetje të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar si dhe të gjithë Legjislacionit Shqiptar në fuqi;

Sot, në Tiranë, me datë **30.12.2021**, Ortakët e poshtëshënuar themeluan Shoqërinë “CIBE ALBANIA” Sh.p.k, e cila do të organizohet dhe do të drejtohet sipas këtij Statuti të trajtuar në të njëjtën dokument me Aktin e Themelimit.

Ortakët e shoqërisë janë:

- 1. Z. Andi Rramilli**, lindur më 07.03.1991, në Tiranë dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, mbajtës i pasaportës shqiptare me Nr. BB2949909, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- 2. Z. Muhammad Zubair**, lindur më 13.07.1978, në Multan, Pakistan dhe banues në Emiratet e Bashkuara Arabe, shtetas pakistanez, mbajtës i pasaportës pakistaneze me Nr. AD5099415, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

#### KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

##### Neni 1


##### Themelimi, Forma dhe Emërtimi i Shoqërisë

- 1.1** Krijohet Shoqëria “CIBE ALBANIA” Sh.p.k.
- 1.2** Shoqëria është Person Juridik Privat dhe një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.
- 1.3** Shoqëria do të paraqitet me emërtimin tregtar “CIBE ALBANIA” Sh.p.k. Ky emërtim do të jetë i vetmi që do të përdoret nga shoqëria në të gjitha regjistrimet, transaksionet, marrëveshjet dhe komunikimet e saj me të tretët apo shtetin dhe është i vlefshëm si jashtë dhe brenda vendit.
- 1.4** Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.5** Shoqëria do të ketë vulën dhe logon e saj identifikuese, në formën e caktuar nga Ortakët e shoqërisë.

##### Neni 2

##### Themeluesit

- 2.1** Shoqëria është themeluar nga Ortakët e poshtëshënuar:
  - 1. Z. Andi RRAMILLI;**
  - 2. Z. Muhammad ZUBAIR.**





### Neni 3

#### Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

3.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me legjislacionin tregtar aktual shqiptar do të jetë:

*“Të veprojmë si konsulent duke ofruar shërbime këshillimore dhe teknike në fushën e financës dhe bankingut, financës dhe bankingut Islamik, Takafulit, Sukukut, fondit Islamik, mirofinancimit Islamik, Shariah etj., për çdo subjekt publik ose privat brenda dhe jashtë vendit. Të asistojë klientët e saj (persona fizik, juridik, privat ose publik/shtetëror) në përgatitjen e kërkesave të tyre për kredi në banka sipas sistemit bankar dhe financiar Islamik. Kryerja e studimeve kërkimore në lidhje me Financën dhe Bankingun Islamik, organizimi i trajnimeve, konferencave, workshopeve brenda dhe jashtë vendit që lidhen me Financën dhe Bankingun Islamik. Ofrimi i shërbimeve të konsulencës për persona fizik, juridik, privat ose publik/shtetëror. Konsulencë në menxhanim, në sektorin e hotelerisë dhe turizmit, konsulencë në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore. Dhënie e asistencës për biznese shqiptare në fushën e standarteve ndërkombetare. Veprimtari në fushën e çertifikimit të Kompanive sipas Standardeve Ndërkombetare. Veprimtari në fushën e çertifikimit HALAL. Veprimtari në fushën e Çertifikimit të produkteve e personelit sipas Normave të njohura ndërkombetarisht. Veprimtari në fushën e organizimit të trajnimeve për tema të çertifikimit ndërkombetar. Shoqëria mund të kryej çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi si dhe mund të kryejë çdo operacion ekonomik që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.”*

3.2 Shoqëria brenda hapësirave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë së saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive të reja, krijimin e sipërmarrjeve të reja dhe pjesëmarrjen në sipërmarrje të tjera, si brenda dhe jashtë vendit.

3.3 Shoqëria mund të kryejë edhe aktivitete të tjera shtesë, me qëllim përmbushjen e veprimtarisë të saj kryesore në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

### Neni 4

#### Selia e shoqërisë dhe degët

4.1 Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë në adresën: Rruga e “Barrikadave”, Vila Nr. 184, Përballë Shkollës “Sami Frashëri”, Tiranë.

4.2 Transferimi i selisë së shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

4.3 Shoqëria ka të drejtë të operojë me zyra, filiale, degë apo agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë apo dhe jashtë vendit.

4.4 Zyrat, filialet, degët apo agjensitë krijohen me Vendim të Ortakëve të Shoqërisë, të cilët organizojnë punën dhe emërojnë organet drejtuese dhe përfaqësuesit e tyre ligjor.



**Neni 5**

**Kohëzgjatja e shoqërisë**

- 5.1 Kohëzgjatja e shoqërisë “CIBE ALBANIA” Sh.p.k është e pakufizuar dhe fillon në momentin e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar.
- 5.2 Ky afat mund të ndryshohet në çdo kohë me vendim të ortakëve të shoqërisë.
- 5.3 Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të ortakëve të shoqërisë.

**KAPITULLI II  
KAPITALI THEMELTAR**

**Neni 6**

**Kapitali Themeltar**

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është **100 lekë (Njëqind lekë)** dhe përbëhet nga **2 (dy) kuota**. Kontributet e Ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.
- 6.2 Pronësia mbi kapitalin themeltar të shoqërisë është:
- 51 % për Z. Andi Rramilli dhe;
  - 49 % për Z. Muhammad Zubair.
- 6.3 Pjesëmarrja e Ortakëve në Shoqëri është në raport me kontributet e tyre dhe vlera nominale e kuotës së secilit Ortak llogaritet në raport me secilin kontribut, paraqitur si më poshtë:

| Nr.    | Emri i Ortakut  | Kuota | Vlera (lekë) | Kapitali (%) |
|--------|-----------------|-------|--------------|--------------|
| 1      | Andi Rramilli   | 1     | 51 Lek       | 51%          |
| 2      | Muhammad Zubair | 1     | 49 Lek       | 49%          |
| TOTALI |                 | 2     | 100 Lek      | 100%         |

- 6.4 Kapitali themeltar është shlyer plotësisht nga ortakët përpara regjistrimit të kësaj shoqërie.
- 6.5 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**Neni 7**

**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

- 7.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së Administratorit.
- 7.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 7.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkojnë për ndryshimin e statutit.
- 7.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.



m. #



**Neni 8**

**Transferimi i kapitalit**

- 8.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - ç) dhurimit;
  - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 8.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.
- 8.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.


**KREU III**

**ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

**Neni 9**

**Organi Vendimmarrës**

- 9.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 9.2 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 9.3 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
  - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 9.4 Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 9.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.



m. #  
4 | F a q e



9.6 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### Neni 10

#### Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

- 10.1 Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 10.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### Neni 11

#### Kuorumi

- 11.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 11.2 Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 11.3 Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### Neni 12

#### Marrja e vendimeve

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 12.2 Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :
- përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - përcaktimin e shpërblimeve

m. #  
5 | F a q e



*“Statuti i Shoqërisë”*

- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 12.3 Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB-së për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.
- 12.4 Çdo vendim i Asamblesë së Përgjithshme do të quhet i vlefshëm nëse votohet nga ana e ortakëve të shoqërisë duke qënë të pranishëm personalisht në mbledhjen e asamblesë, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike (e-mail) etj.

**Neni 13**

**Përgjashtimi nga e drejta e votës**

- 13.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 13.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

**KAPITULLI IV  
DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

**Neni 14**

**Administratori**

- 14.1 Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj:
- *Z. Andi Rramilli, lindur më 07.03.1991, në Tiranë dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, mbajtës i pasaportës me Nr. BB2949909, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;*
- 14.2 Administratori i shoqërisë emërohet me një afat 5 (pesë) vjeçar.
- 14.3 Administratori do të ketë të drejtë për rimbursimin e shpenzimeve të bëra prej tij për llogari të shoqërisë.
- 14.4 Kur administratori i shoqërisë rezulton i suksesshëm në punën e tij dhe në rezultatin financiar të kompanisë, atëhere Ortakët e shoqërisë vendosin lidhur me shpërblimin që do ti jepet atij në fund të vitit financiar.

**Neni 15**

**Kompetencat e Administratorit**

- 15.1 Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
- a) kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;



- b) përfaqësoj shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatitisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijoj një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryej regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- g) raportoj përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryej detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

15.2 Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.;
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

15.3 Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## KAPITULLI V VITI FINANCIAR , BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMIT

### Neni 16

#### Viti financiar

16.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

### Neni 17

#### Ekspertët

17.1 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithë-vjetor dhe atë në lidhje



me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

17.2 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t’ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t’i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

## KREU VI PRISHJA -RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

### Neni 18 Prishja dhe likuidim

18.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me ligjin nr. 131/2015.
- e) me vendim të gjykatës;

18.2 Në këtë rast Ortakët merrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në ëdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

18.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

18.4 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

### Neni 19 Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

19.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

### Neni 20 Baza Ligjore

20.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.



**Neni 21**

**Mosmarrëveshjet**

21.1 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptar.

**Neni 22**

**Fitimi që shpërndahet**

22.1 Koha, mënyra dhe shuma e fitimit që shpërndahen vendoset rast pas rasti nga Ortakët e shoqërisë sipas raportit të administrimit në përputhje me këtë Statut, ligjin tregtar dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

**Neni 23**

**Hyrja në fuqi**

23.1 Ky statut hyn në fuqi dhe është i detyrueshëm për zbatim në momentin e firmosjes nga Ortakët themelues të shoqërisë.

**ORTAKËT**

**E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

\*\*\*CIBE ALBANIA Sh.p.k \*\*\*

ANDI RRAMILLI

Andi Rramilli



MUHAMMAD ZUBAIR

MUHAMMAD ZUBAIR

